



Postuar më: 15:42 - 25/06/2011



"Ngrihen" 3 milionë euro të pronarit të Albanian Airlines



Kusari-Lila udhëtoi për në Vienë



Avdiu pjesë në takimet e Bankës Islamike

Mitrovicë: Përkrahet bujqësia

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) ka prezantuar të shtunën në Vaganicë të Mitrovicës dhe Çabër të Zubin Potokut projektin "Promovimi i bujqësisë, hortikulturës, blegtorisë dhe përpunimit të frutave në rajonin e Mitrovicës", i cili është financuar nga Bashkimi Evropian.

Zenel Bunjaku, drejtor ekzekutiv i IADK-së, e cila është njëherësh implementuese e këtij projekti, ka falënderuar Bahskimin Evropian për vazhdimin e mbështetjes për fermerët përmes projekteve të ngjashme.

"Ju jemi mirënjohës Bashkimit Evropian për ndihmën, komunave dhe fermerëve për guximin e tyre, për kalimin nga forma tradicionale në kultivimin intensiv të kulturave bujqësore", ka thënë Bunjaku.

Sipas tij, në serrën në Çabër janë investuar mbi 15 mijë euro dhe kjo serrë plotëson të gjitha kriteret e parapara sipas standardeve të BE-së, ndërsa në pemishten e Vaganicës janë investuar rreth 12 mijë euro.

Brajan MekKarti, përfaqësues i Asistencës Teknike të EURED-it, shprehu kënaqësinë për këtë projekt.

"Unë shoh punë të mbarë këtu, dhe shpresoj se këto pika demonstruese do të ndihmojnë fermerët të zhvillojnë kultivimet sipas praktikave më të mira dhe të bëhen konkurrent me supermarketet të produkteve bujqësore, ashtu siç po ndodhë në Irlandë e gjetiu në Evropën perëndimore", ka thënë ai.

Po ashtu, zv. kryetari i komunës së Mitrovicës Riza Haziri, sqaroi angazhimin e komunës për të bashkëpunuar dhe bashkë-financuar projekte të qëndrueshme dhe të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e qytetarëve.